

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QARKU KUKES
KËSHILLI I KOMUNËS LEKBIBAJ

V E N D I M

Nr. 18 datë 20.08/2014

PËR

KRIJIMIN E ADMINISTRATËS PËR RUAJTJEN DHE MENAXHIMIN E PARKUT
NATYROR RAJONAL NIKAJ-MERTUR

Në mbështetje të pikës.... të Vendimit të Këshillit të Qarkut Kukës "Për shpalljen e Parkut Rajonal Nikaj-Mërtur, të Ligjit nr. 8906, datë 06.06.2002 „Për zonat e mbrojtura“, të ndryshuar dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 266, datë 24.4.2003 "Për administratat e zonave të mbrojtura", VKM nr. 519, datë 30.06.2010 "Për procedurat e propozimit e të miratimit dhe rregullat e administrimit të parqeve natyrore rajonale"

V E N D O S I

1. Krijimin e administratës së Parkut Natyror Rajonal "Nikaj-Mërtur" me qëllim të forcimit të rolit të saj në mbrojtjen e natyrës, të biodiversitetit, të llojeve floristike e faunistike dhe të ekosistemeve natyrore të këtij parku, si edhe të zhvillimit të qëndrueshem të zonës.
2. Administrata e Parkut Natyror Rajonal "Nikaj-Mërtur" administron dhe menaxhon, në bashkëpunim me strukturat përkatëse të komunës dhe aktorët e tjerë të interesuar, sipërfaqet e përdorimit të territorit të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Qarkut dhe sipas hartës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Detyrat e administratës së Parkut Natyror Rajonal "Nikaj-Mërtur" përcaktohen në dispozitat e ligjit "Për zonat e mbrojtura" të ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave "Për Administratat e zonave të mbrojtura" dhe në rregullore të veçanta. Administrata harton rregulloren e funksionimit të Parkut Natyror Rajonal "Nikaj-Mërtur", e cila miratohet nga Këshilli i Qarkut.


4. Struktura e administratës së Parkut Natyror Rajonal "Nikaj-Mërtur" miratohet sipas aneksit bashkëlidhur këtij vendimi.
5. Zyra e Parkut Natyror Rajonal "Nikaj-Mërtur" do të jete brenda ambienteve të zyrave të komunes Lekbibaj.
6. Administrata e Parkut Natyror Rajonal "Nikaj-Mërtur" është strukturë në vartësi të Komunës Lekbibaj.
7. Pershkrimet e punes, detyrat dhe funksionet e punonjesve të parkut jepen në planin e menaxhimit të parkut.
8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen strukturat perkatëse në Komunën Lekbibaj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI I KOMUNËS LEKBIBAJ

KRYETARI

[Signature] 2014



SEKRETARI

[Signature]

Aneksi

Struktura dhe Numri i Punonjësve të Administratës
Parku Natyror Rajonal "Nikaj-Mërtur"

Nr.R	Funksioni	Nr. Punonjësve
1	Menaxheri i parkut	1
2	Specialist për komunikimin dhe marrdheniet me publikun	1
3	Specialist per biodiversitetin	2
4	Specialist per financat	1
	GJITHSEJT	5